




Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)

Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-19798 dt. 29/05/ 2025



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenin 17 pika 1, 2, nenit 38 pika 1 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 34 pika 34.6 pika (h) të Statutit të Komunës së Glllogocit, të datës 16.09.2008, në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës më 01-Nr. 020/04-14665, të datës 22/04/2025. Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.05.2025, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN TË RREGULLORES PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE

Neni 1

Qëllimi

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartëcekura në parahyje të këtij propozimi për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve, propozohet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores me nr.320-19338, të dates 07.04.2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve dhe Rregullores Nr. 01-400/01-18380 dt.27.04.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për ndarjen e Subvencioneve, si dhe në bazë të rrethanave të reja shihen disa kriteret dhe dokumentacione të disa Drejtorit Komunalë në Drenas.

Neni 2

Subvencionet për Arsim

Të neni 11 të pika 1.1 të subvencionet për arsim, të kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave, ndryshohen dhe plotësohen kriteret dhe pikët e kategorive të përfutuesve të bursës komunale dhe hiqet një pikë, tek nënpika të 1.1.1, 1.1.2, 1.1.3, 1.1.4, 1.1.5 dhe 1.1.6, pastaj të numri i studenteve në familje bëhet modifikim dhe sqarim i anëtarit të ngushtë të familjes, të kategoritë e dalura nga lufta hiqet neni 1.3.1, shtohet një kategori e re të neni 11 të pika 1.5, tek dokumentet e kërkuara për të aplikuar për bursë komunale, të neni 13 pika 1.2.1 bëhet modifikim dhe sqarim i certifikates se notave të fundit të shkollës së mesme të lartë.

Neni 3

Kriterët dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave

1. Përcaktohen kriteret dhe dokumenta të qarta më keqë propozim rregullorë për dhënien e bursave, duke përfshirë :

1.1. Notën mesatare;

1.1.1. Prej 6 deri 6.99	- 15 pikë
1.1.2. Prej 7 deri 7.99	- 25 pikë
1.1.3. Prej 8 deri 8.99	- 35 pikë
1.1.4. Prej 9 deri 10	- 45 pikë
1.1.5. Me deftesën shumë mirë	- 25 pikë
1.1.6. Me deftesën shkëlqyshëm	- 35 pikë

1.2. Numri i studentëve në familje;

1.2.1. Vetëm njeri student/e në familje e ka të drejtën e përfundit të bursës komunale, i cili/a ka më shumë pikë apo nëse janë barabartë më pikë, pastaj më notën më të lartë mesatare dhe studentit që ka më shumë pikë (vëlla, motër) apo më pikë të barabarta por më notë mesatare më të lartë i shihen 5 pikë, nëse i ka edhe dy,tri studentë i shihen edhe nga 5 pikë.

1.3. Kategoritë tjera;

1.3.1. Student me prind më nevoja të veganta - 5 pikë,

Neni 4

Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë :

1. Certifikata e notave të studimeve (kandidatët që janë në vitin e parë të studimeve Bachelor dhe që nuk kanë nota në studime duhet të sjellin dëshmi nga fakulteti që ende nuk kanë nota dhe duhet të sjellin Certifikatën e notave të klasës së fundit të shkollës së mesme të lartë, të vijtë paraprak (nuk pranohet deftesa e kl. XII-të të viteve më herët apo viteve tjera më herët) të klasës XII –të.

Neni 5

Subvencionet për Zhvillim Ekonomik

Të neni 15 tek dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione për zhvillim ekonomik, i shtohen tri dokumente.

Neni 6

1. Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione për zhvillim ekonomik

- 1.1. Vërtetimi që nuk kanë obligime ndaj takssë komunale për biznes;
- 1.2. Certifikata dhe informatat e biznesit (Kërkohen me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes vetëm për përfutuesit),
- 1.3. Përparësi në aplikim kanë bizneset aktive.

Neni 7

Subvencionet për Bujqësi

Të subvencionet për bujqësi, të neni 17 hiqet pika 1.9, të neni 19 të hiqet pika 1.4, pastaj të pika 2 plotësohen dhe ndryshohen nëpikat 2.2 , 2.3 dhe 2.4 (zëvendësohen me dy të tjera) si dhe të hiqet nëpika 2.6, të neni 18 shtohen dy paragrafe të reja.

Neni 8

1. Në nenin 17 tek Komuna mund të ndajë subvencione për bujqësi, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

1.1. Projekte për shpeztari dhe

1.2. Përkrahje për fermerë me inpute bujqësore ose edhe me material fidanor.

2. Pikat që do të plotësohen dhe ndryshohen (zëvendësohen) të neni 17, janë:

2.1. Grave, të rinjëve familjeve që kanë persona me nevoja të veçanta, familjeve të marginalizuara;

2.2. Aplikantëve që nuk kanë përfutur nga komuna në ndonjë projekt nga lëmia e bujqësisë në vitin e fundit (paraprak), ndërsa aplikuesit që kanë përfutur në ndonjë projekt në lëmin e bujqësisë mbrenda vitit fiskal nuk kanë të drejtë përfutimi në projektet pasuese.

2.3. Projektet e personave juridik, OJQ-ve, kooperativave, etj që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës jo më pak se 50% të vlerës totale të projektit.

3. Të neni 18 shtohen pikat e reja si:

3.1. Aplikacioni i plotësuar,

3.2. Dëshmi që kanë persona më nevoja të veçanta ose që janë pjesë e familjeve të marginalizuara.

Neni 9

Subvencionet për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale

Të subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenje sociale, plotësohet dhe ndryshohet paragrafi 2.3. i neni 21, shtohën dhe plotësohet paragrafi 2.4. i neni 21, plotësohet dhe ndryshohet paragrafi 2.6, të paragrafi 2 i neni 21 shtohet edhe dy nënparagrafe të reja, të paragrafi 3 i neni 21 shtohet një nënparagraf, të paragrafi 4 të neni 21 shtohet dy nënparagrafe, pastaj shtohen 5 nene, ku secili nen i ka disa paragrafe dhe nënparagrafe të reja, në rënditje pas paragrafit 4 të neni 21.

Neni 10

Plotësohet paragrafi 2.3 i nenit 21, konstatimin nga kolegji i mjekëve për gjëndjen e rënde shëndetësore dhe se sëmundja e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike apo mungon terapia e nevojshme,

Plotësohet dhe ndryshohet paragrafi 2.6 i nenit 21, ne rast të varfërisë së skajshme të individit apo familjes, të sëmundjeve të rënda kronike, të familjeve me përkujdesje të fëmijëve me çrregullime të përhershme shëndetësore, me fëmijë dhe persona të moshës madhore, të cilët janë persona me aftësi të kufizuara dhe që janë banorë të komunës së Drenasit.

Tek paragrafi 2 i nenit 21, për familjet të cilat nuk kanë të zgjidhur çështjen e banimit, jetojnë me qera dhe me gjendje jo të mirë financiar, shtohet dy nenparagraf të ri:

2.7. Sëmundjet, terapia e së cilave nuk është e përfshirë në listën esenciale dhe

2.8 familjet të cilat nuk kanë të zgjidhur çështjen e banimit, jetojnë me qira dhe me gjendje jo të mirë financiare.

Tek paragrafi 3 i nenit 21, shtohet nenparagrafi 3.6 për personat që nuk kanë përfutur gjatë dy viteve të fundit.

Të paragrafi 4.1 i nenit 21 plotësohet dhe ndryshohet, tek diagnoza e mjekut specialist (raporti i mjekut jo më i vjetër se 6 muaj) dhe shtohen dy nenparagrafe tek paragrafi 4 i nenit 21, dokumentacionet e paraqitura:

1. Dëshmia e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare
2. kopjen e lejeqendrimit (për shtetasit e huaj: azilkerkuesit, refugjatet dhe personat që gezojnë mbrojtje të perkohshme).

Neni 11

Qiraja jo profitabile e Subvencionuar për pagesë të familjeve me gjendje të rënde sociale të cilat nuk e kanë të zgjidhur qeshijen e banimit.

1. Kuvendi Komunal miraton buxhetin për pagesën e qirasë për familjet në nevojë përmes miratimit vjetor të buxhetit, për rastet të cilat parqesin në organet kompetente komunale.
2. Komuna ka të drejtën e pagesës së qirave për familjet apo individët e Komunës së Drenasit që nuk e kanë të zgjidhur qeshijen e banimit për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike .
3. Numri i familjeve përfutuese nga kjo kategori përcaktohet në pajtim me ndajën buxhehore sipas paragrafit 1 të këtij neni.
4. Të drejtën e subvencionimit e kanë banorët të cilët në Komunën e Drenasit janë rezident së paku prej pesë (5) viteve
5. Qiraja e subvencionuar nga buxheti i komunës nuk mund të kalojë shumën prej (175 €) Euro, për një (1)-muaj
- 6 .Pëjashitimi i nenit 1.5 për familjet që në përbërjen e tyre kanë një person me aftësi të kufizuara, apo një person me sëmundje të rëndë kronike, si dhe për raste të tjera të ngjashme, Kuvendi komunal mund të miratojë vlerë më të lartë të bonusit se sa vlera e përcaktuar sipas nenit 17 të ligjit 03/L-164.

Kriteret specifike të detajuara do të publikohen në thirrjen për aplikim do të përpilohen nga Drejtoria dhe të miratohen nga Kryetari i Komunës.

Neni 12

Percaktimi i kriterëve dhe i radhës së përparsisë për kategoritë e familjeve në gjendje të nevojës të cilat mund të subvencionohen për pagesën e qirasë.

1. Kriteret për përcaktimin e radhës së përparsisë për sigurimin e banimit për personat / familjet e paraqitura :

- a. statusi i banimit
- b, lartësia e të ardhurave;
- c. gjendja shëndetësore
- d. invaliditeti, dhe
- e. struktura e familjes.

Neni 13

Përparesite në përzgjedhjen e familjeve të subvencionuara

1. Përparesi në përzgjedhjen e përfutuesve për subvencionim të qirasë kanë:
 - a) familjet me shumë fëmijë;
 - b) familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me nevoja të veçanta
 - c) familjet ku kryefamiljari është grua -vetëushqyese e familjës
 - d) bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurotëzuar që ka në përkujdesje fëmijë dhe
 - e) fëmijët me statusin e jetimit .

Neni 14

Afati për pagesën e qirasë së banimit

Pas aprovimit të propozimeve nga Kryetari i Komunës, drejtori i DSHMS lidhë kontratë me pronarin e banesës ku përfutues është familja apo individit që i plotëson kriteret sipas kësaj rregullore.

1. Pagesa e qirasë së banimit nuk mund të bëhet më tepër se për pesë (5) vite.
2. Kontrata lidhet në afat një (1) vjeçar me mundësi të vazhdimit konform afatit të parapare në paragrafin 2 të këtij neni.
3. DSHMS - ja njofton përfutuesin e subvencionit dhe qiradhënësin e qirasë së banimit së paku (60) dite para përfundimit të afatit të kontratës së fundit (për herën e pestë) së komuna nuk do të vazhdojë ti paguajë qirane e banimit dhe nuk do të lidhë kontratë të re të banimit,

Neni 15

Rastet e ndërprerjes së subvencionit të qirasë jo profitabile (shkëputja e kontratës së qirasë).

1. Palës përfutuese të subvencionimit të qirase, i ndërpriet e drejta për pagesë (shkëputja e kontratës së qirasë) kur:
 - a) qiramartresi ka bërë deklaram të rrejshem për të ardhurat;
 - b) qiramartresi ka përfutuar një banesë tjetër dhe nuk e ka njoftuar organin kompetent të komunës;
 - d) qiramartësi ia lëshon banesën me qira palës së tretë;
 - e) qiramartësit i peçmirësohet gjendja ekonomike, të cilin fakt e vlerëson në baza vjetore nga Komisioni Vlerësues i DSHM-se;

g) qiramarrësit i punësohet një nga anëtarët e familjët me pagesë mbi pagën minimale dhe i) qiramarrësi i kalon pesë (5) vite nga momenti i lidhjes së kontratës.

Ndarja e subvencioneve në fushën e strehimit/banimit do të bëhet në bazë të Udhëzimit Administrativë Nr.19/2010 për Përmbajtjen e Bonusit të Banimit
Kriterët, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve si dhe shumat e subvencionimit të parapara nga kjo kategori do të përcaktohen në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga Drejtoria përkatëse.

Neni 16

Subvencionet për OJQ

Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për organizata (OJQ) përfshijnë, duke mos u kufizuar:

1. Aplikacioni
2. Certifikata për regjistrimin e OJQ-së,
3. Dokumenti identifikues i personit të autorizuar
4. Projekt-propozimi duke përfshirë pjesën narrative dhe atë financiare
5. Dëshmi se subvencioni i pranuar nga viti paraprak është përmbyllur sipas destinimit për çka është ndarë me dëshmitë përkatëse
- 6 Dëshmi e pagesës së tatimit në pronë
7. Konfirmimin nga banka për xhirrollogarinë e aplikuesit

Ndarja e subvencioneve për OJQ në fushën e mireqenies sociale do të bëhet në bazë të Rregullores MF-04/2017, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve

Neni 17

Subvencionet në Drejtorin e Sherbimeve Publike dhe Emergjencë

1. Ne pajtim të nenet 7 të ligjit 04-L-012 për Mbrojtje nga Zjarr, të behet subvencionimi i rasteve në raste të dëmtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
2. Dokumentacioni që kërkohet nga palët e dëmtuara është:
 - 2.1. Kërkesa për vlerësimin e dëmeve nga pronari për rastet e dëmtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në objekte banimi, objekte ndihmës, stalle bagëtish dhe ushqim kafshësh;
 - 2.2. Kopja e letërnjoftimit;
 - 2.3. Konfirmimi i bankës (për përfutjesin).
3. Me poshtë po ju përcejllim edhe tabelën për subvencionim për kategoritë e dëmtuara.

Nr.	Lloji i Objektit	Lloji i shkaktarit të dëmit	Vlera e Dëmit/€	Përqindja e kompensimit	Lloji i shkaktarit të dëmit	Vlera e Dëmit/€	Përqindja e kompensimit
1	Objekt banimi	Zjarr/vërshim et	Deri 999 €	15%	Era/ Breshëri	Deri 999 €	10%
			1000-9999 €	10%		1000-9999 €	8%
			10000-29999 €	8%		10000-29999 €	6%
			30000-49999 €	6%		30000-49999 €	4%
			50000-99999 €	4%		50000-99999 €	3%
			mbi 100000 €	3%		mbi 100000 €	2%
2	Objekt ndihmës	Zjarr/vërshimet	Deri 999 €	15%	Era/ Breshëri	Deri 999 €	10%
			1000-5000 €	10%		1000-5000 €	8%

3	Stallë bagëtish	Zjarr/ vërshimet	Deri 999 €	15%	Era/ Breshëri	Deri 999 €	10%
			1000-10000 €	10%		1000-10000	8%
4	Ushqim kafshësh i deponuar në pleme apo afër stallës	Zjarr/ vërshimet	Deri 999 €	15%	Era/ Breshëri	N/A	
			1000-10000 €	10%		N/A	

A r s y e t i m

Të subvencionet për Arsim, tek neni 3 tek kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave (shih më lartë prej neni 1 të nënparagrafi 1.1.1 deri 1.1.6) janë parapartë 100 pikë në total, prej tyre sa i përket notes mesatare deri në 45 pikë dhe posedimin e dokumentacionit tjetër deri në 55 pikë, ku dukumentacioni përftshihet tek numri i studentëve në familje, kategori të e dala nga lufta, student që studiojnë në drejtimet deficitare, kategori të tjera dhe gjëndja ekonomike.

Ne nenin 3 paragrafi 1.3.1 si më lartë është parapartë një kategori e re (Student me prind më nevoja të veganta), ka pasur ankesa tek studentet që kanë pasur prind më nevoja të veganta, pse nuk janë përftshirë në peoenizim.

Të neni 4 tek (shih më lartë nenin 1) tek Certifikatën e notave të klasës së fundit të shkollës së mesme të lartë, të vitit paraparak (nuk pranohet deftesa e kl. XII-të të dy viteve më herët apo viteve tjera më herët) të klasës XII –të, ngase ka pasur raste ma shumë se një, dy, tri apo me shumë vite e kanë kryer shkollën e mesme, e kanë rexhistruar fakultetin dhe kanë përftuar bursën komunale, qka ka pasur ankesa tek shumë student/e që vetëm sa me marrë një bursë komunale po e rexhistrojnë fakultetin e jo për ti vazhduar apo kryer fakultetin.

Keto ndryshime lidhen me plotësim ndryshimin e Rregullorës me nr:400/01-18380 dt: 27.04.2022 për ndarjen e subvencioneve.

Te subvencionet për Zhvillim Ekonomik, Të neni 15 tek dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione për zhvillim ekonomik, shtohen tri dokumente (lidhur me plotësim ndryshimin e Rregullorës me nr.400/01-18380 dt: 27.04.2022 për ndarjen e subvencioneve).

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione për zhvillim ekonomik:

1. Vërtetimi që nuk kanë obligime ndaj takses komunale për biznes;
2. Çertifikata dhe informata e biznesit (kërkohen me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes vetëm për përfutuesit),
3. Përparësi në aplikim kanë bizneset aktive.

Keto dokumentacione janë shtuar duke u lidhur dhe në bazë të Rregullores me nr. 12-400-16587 te dt. 27.05.2020 për ndryshim plotësim për taksa, tarifa, ngastra dhe gjoba.

Te subvencionet për Bujqësi, hiqet pika 1.4 nga neni 19 (i Rregullorës më nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 për ndarjen e subvencioneve), respektivisht hiqet pika 1.9 nga neni 17 (i plotësim ndryshimi i rregullorës me nr 02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022 për ndarjen e subvencioneve) hiqen për arsye se sektori i pylltarisë nuk i takon as me status drejtorisë së bujqësisë (konfirmimi i ligjshmërisë me nr. 020-435/28 te dt. 12.11.2024 të MAPL). Pika 2.6 nga neni 17 hiqet për arsye të ndryshimit në kriteret e përparsisë në kushte të barabarta, si dhe te neni 18 (i plotësim ndryshim i Rregullorës me nr 02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022 për ndarjen e subvencioneve), shtohen dy pika të reja.

Të subvencionet për Shëndetësi dhe Mirëqenja Sociale,

Plotësohet paragrafi .2.3 te neni 21 (i rregullorës më nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 për ndarjen e subvencioneve), konstatimin nga kolegji i mjekëve për gjëndjen e rënde shëndetësore dhe se sëmundja e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike apo mungon terapia e nevojshme.

Plotësohet dhe ndryshohet parag 2.6 I neni 21 (i rregullorës më nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 për ndarjen e subvencioneve), ne rast të varfërisë së skajshme të individit apo familjes, të sëmundjeve të rënda kronike, të familjeve me përkujdesje të fëmijëve me çrregullime të përhershme shëndetësore, me fëmijë dhe persona të moshës madhore, të cilët janë persona me aftësi të kufizuara dhe që janë banorë të komunës së Drenasit , Kryetari i Komunës në bazë të kërkesave të arsyetuara, ndan ndihma momentale të njëjshme dhe forma të tjera të mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, sipas ndarjeve të aprovuara me buxhet të Komunës. per shkak që përveq lehtësirave të komisionit i ipet mundësia ne mbulimin e shpenzimeve rasteve të cekura në keto pika

Tek parag 2 i neni 22 (i rregullorës më nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 për ndarjen e subvencioneve), për familjet të cilat nuk kanë të zgjidhur çështjen e banimit, jetojnë me qera dhe me gjendje jo të mirë financiar, shtohet dy nenparagraf të ri: 2.7 Sëmundjet, terapia e së cilave nuk është e përfshirë në listën esenciale dhe 2.8 Familjet të cilat nuk kanë të zgjidhur çështjen e banimit, jetojnë me qira dhe

me gjendje jo te mire financiare, këto dy nënparagrafe hyjnë neni 2 me arsyen e dhënjes së mundësisë së barabart të gjitha kategorive të dhe rasteve në nevojë,qoftë rehabilitim mjekësorë apo strehim.

Tek neni 3 i neni 21 (i rregullorës më nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 për ndarjen e subvencioneve), shihet nenparag. 3.6 personat që nuk kanë përfituar gjatë dy viteve të fundit, kjo shihet me arsyetimin per ti dhënë përparësi rasteve të reja.

Te paragrafi 4.1 i neni 21 (i rregullorës më nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 për ndarjen e subvencioneve) plotësohet dhe ndryshohet, tek diagnoza e mjekut specialist, raporti i mjekut jo me i vjetër se 6 muaj, me arsyetimin se ka pasur raste që kanë kërkuar kompenzim për rehabilitim pas gjashtë muajve, një viti apo me shumë vite).

Shihet dy nenparagrafe tek neni 4 te neni 21 (i rregullorës më nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 për ndarjen e subvencioneve) dokumentacionet e paraqitura:

- a) Dëshmia e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare
- b) kopjen e lejeqendrimit (per shetaset e huaj: azilkerkuesit, refugjatet dhe personat që gezojne mbrojtje te perkohshme).

Pastaj shihen 5 nene, ku secili nen i ka disa paragrafe dhe nenparagrafe te reja, në rënditje pas paragrafit 4 të neni 21.

I gjithë ky plotësim dhe ndryshim është bërë për të lehtësuar punen e komisionit e poashtu lehtësuar paraqitëseve të kërkesave rehabilitimit mjekësor apo strehimit ne përfshirje të barabartë dhe pa diskriminuar rastet në nevojë.

Është shtuar neni 1, 2, 3, 4,5 lidhur me subvencionimin e qirasë jo profitabile për arsye të domosdoshmërisë së implementimit të U.A Nr.19/2010 për Përmbytjen e Bonusit të Banimit dhe lehtësimit të kushteve për kategori të përcaktuara për ndihmë në strehim si kusht elementar i jetës

Poashtu shihet paragrafi 5 Subvencionimi i OJQ-ve bazuar në atë se DSHMS subvencionin pothuajse çdo vit OJQ –të e kategorive sociale dhe PAK.

Të subvencionet për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarr, i cili parashihet përkrashjen institucionale në rastet e dëmtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë (DShPE) propozon plotësim-ndryshimin e Rregullores për subvencione, me qëllim që të mundësohet edhe kompensimi për qytetarët e prekur nga këto raste.

Ky propozim është bërë duke marrë parasysh nevojën për të ofruar një reagim të shpejtë dhe human në raste të tilla, me qëllim të zbutjes së pasojave sociale dhe ekonomike për qytetarët e dëmtuar.

Megjithatë, duke pasur parasysh kufizimet buxhetore aktuale të Komunës nga kategoria e subvencioneve, propozimi për përfshirjen e këtij kompensimi është bërë në përputhje me kapacitetet reale financiare. Qmimet e kompensimit janë vendosur në nivele të arsyeshme dhe të menaxhueshme, duke synuar që ndihma të jetë e drejtë dhe në proporcion me dëmin e shkaktuar, pa rrezikuar stabilitetin financiar të komunës.

Neni 18

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Bekim Lestrani
Bekim Lestrani

- Vendimi i dërgohet:
- Zyrës së Kryetarit
 - Drejtorisë Përkatëse;
 - Zyrës së Kuvendit;
 - Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Udhë. Qtd. 02 / KOM / Nr. Prot. 1680-3/2025
Udhë. Lloji. Udhë. Unit. Nr. Prot. 16.06.2025
Nr. i fletës. Dato. 16.06.2025
Dato. 16.06.2025
Dato. 16.06.2025
PRISHTINEJA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Financija, Radnja i Prevoza
Ministry of Finance, Labour and Transfers

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
SHKURIM I PUNËS DHE TRANSFEREVE - REP. E KOSOVËS
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Pushtetit Lokal
Ministartstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data. 16.06.2025
Datum. 16.06.2025
Date. 16.06.2025

Shkruar nga: VI - 453-580/10

Për:	Ramiz Lladrovi, Kryetar i Komunës së Drenasit
Kopje:	Bekim Lestrani, Kryesues i Kuvendit të Komunës Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Avni Zogiani, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Artan Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Bora Duli, Ud. Drejtore të Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Medina Millaku, Zyrtare e Lartë Ligjore për Hartim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Kimete Zekaj, Udhëheqëse e Divizionit për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
Lënda:	Shqyrtim i Ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Rregullor

Inderuari Kryetar z.Lladrovi,
Inderuari Kryesues z.Lestrani,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferëve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Rregullore 02 Nr.400/01-19798 për plotësim ndryshim të Rregullores për ndarjen e subvencioneve.</i>
<i>I miratuar më datë 29.05.2025</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 30.05.2025</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferëve më datë 02.06.2025</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërme të Komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Drenasit, me anë të vendimit, që është subjekt i shqyrtimit, synon plotësim ndryshimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve.
2. Gjatë marrjes së këtij vendimi, komuna obligohet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP") si dhe Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.
3. Duke u bazuar në Nenin 53 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike, komunave ju mundësohet nxjerrja e rregulloreve të tilla. Kjo Rregullore nuk ka kosto shtesë buxhetore, megjithatë ndarja e subvencioneve dhe granteve duhet të bëhet brenda ndarjeve buxhetore të planifikuara me Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.

Neni 53

Kufizimet në Grante, Donacione dhe Subvencione

53.1 Asnjë organizatë buxhetore ose autoritet publik nuk mund të japin një grant, donacion ose subvencion për një person ose ndërmarrje, përveç dhe deri në masën e lejuar shprehimisht nga një ligj mbi ndarjet buxhetore.

4. Nga ajo që u thuhet më lartë, Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve evidenton se Rregulloria 02 Nr.400/01-19798 për plotësim ndryshim të Rregullores për ndarjen e

subvencioneve është nxjerrur konform legjislacionit në fuqi, me kusht që ndarja e subvencioneve të bëhet brenda ndarjeve buxhetore të përcaktuar me Ligjin Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit, dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë qëshije mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

PCL XL error

Warning: IllegalMediaType